

**VENDIM****Nr. 1064, datë 23.12.2015**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT
TEKNIK “PËR KËRKESAT E
EFICIENCËS PËR BOJLERËT E UJIT
QË PËRDORIN LËNDË DJEGËSE TË
LËNGËT OSE TË GAZTË”¹ DHE
PËRCAKTIMIN E LISTËS SË
STANDARDEVE TË HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 2, e 42, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat e eficiencës për bojlerët e ujit që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë”, sipas tekstit që i

bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të bojlerëve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të bojlerëve me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Direktiva e Këshillit Evropian 92/42/EEC, e datës 21 maj 1992, “Mbi eficiencën e bojlerëve me ujë të nxehtë që përdoren me gaz”, ndryshuar nga direktiva 2008/28/EC, numri Celex 31992L0042;

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 167, datë 22.6.1992, faqe 17–28.

**RREGULLI TEKNIK****PËR BOJLERËT E UJIT QË PËRDORIN LËNDË DJEGESE TË LËNGËT OSE TË GAZTË****1. Fusha e zbatimit**

Ky Rregull Teknik përcakton kërkesat e efijencës së energjisë të zbatuara tek bojlerët për ujë të nxehtë dhe që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë me një fuqi nominale jo më pak se 4 kW dhe jo më shumë se 400 kW; këtu e më poshtë të quajtur “bojler”.

2. Përkufizime

Për qëllime të këtij Rregulli Teknik :

- a) “bojler” është një kombinim i konstruksionit të bojlerit me djegësin, i projektuar për të transmetuar tek uji nxehtësinë e çliruar nga djegia;
- b) “pajisje” është:
 - (i) konstruksioni i bojlerit i projektuar për t’u pajisur me një djegës;
 - (ii) djegësi i projektuar për t’u montuar në konstruksionin e një bojleri;
- c) “fuqi efektive nominale” (e shprehur në kW) është fuqia kalorifike maksimale e deklaruar dhe e garantuar nga prodhuesi që çlirohet gjatë funksionimit të vazhdueshëm të pajisjes dhe që është në përputhje me rendimentin e dobishëm të dhënë nga prodhuesi;
- ç) rendimenti i dobishëm“ (i shprehur në %) është raporti i fuqisë së nxehtësisë së transmetuar në ujin e bojlerit me prodhimin e vlerës së nxehtësisë specifike në presion konstant të lëndës djegëse me konsumin të shprehur si sasi e lëndës djegëse në njësinë e kohës;
- d) “ngarkesa e pjesshme“ (e shprehur në %) është raporti i fuqisë efektive të bojlerit që funksionon me ndërprerje ose në fuqi me të ulët se fuqia efektive nominale, me fuqinë efektive nominale;
- dh) “temperatura mesatare e ujit në bojler“ është mesatarja e temperaturave të ujit të matura në hyrje dhe në dalje të bojlerit;
- e) “bojler standard“ është bojleri për të cilin temperatura mesatare e ujit mund të kufizohet nëpërmjet projektit;
- ë) “back-bojler” është bojleri i projektuar të furnizojë një sistem qëndror për ngrohje dhe instalohet në brendësi të një vatre zjarri si pjesë e një bojleri/me kombinim djegie të gazit.
- f) “bojler me temperaturë të ulët” është bojleri që mund të punojë vazhdimisht duke u furnizuar me ujë në temperaturë 35-40°C, ku në disa rrethana mund të ndodhë kondensimi, duke përfshirë edhe bojlerët me kondensim që përdorin lëndë djegëse të lëngët;
- g) “bojler me kondensim me gaz” është bojleri i projektuar për të kondensuar vazhdimisht një pjesë të madhe të avujve të ujit, që përmbajnë gazet e djegshme;
- gj) “bojler që instalohet në hapësira banimi” është bojleri me një fuqi efektive nominale më pak se 37 kW, i projektuar që të japë nxehtësi në pjesë të hapësirës së banimit në të cilën ai është instaluar nëpërmjet emetimit të nxehtësisë nga vendi i montimit në hapësirën e dhomës, duke



dërguar ujë të nxehtë me qarkullim të lirë; bojlerë të tillë do të mbajnë në karkasën e tyre shenjën e qartë që ato duhet të instalohen në hapësira banimi.

h) “Konsumator” është çdo person, i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit. Në kuptim të këtij vendimi, edhe organizatat jofitimprurëse konsiderohen si konsumatorë.

3. Përfshirje

3.1 Përfshihen nga ky Rregull Teknik:

- a) bojlerët për ujë të nxehtë që janë në gjendje të djegin lëndë djegëse të ndryshme duke përfshirë dhe lëndët djegëse të ngurta;
- b) pajisjet për përgatitjen e menjëhershme të ujit të nxehtë ;
- c) bojlerët e projektuar për të djegur lëndë djegëse vetitë e të cilave ndryshojnë dukshëm nga vetitë e lëndëve djegëse të lëngëshme dhe të gazta që tregtohen gjërësisht (gaz mbetjesh industriale, biogas, etj);
- ç) sobat dhe pajisjet e projektuara kryesisht për të ngrohur mjedisin në të cilin ato janë instaluar dhe, që kanë si funksion ndihmës furnizimin me ujë të nxehtë për ngrohjen qendrore dhe për nevoja higjeno-sanitare;
- d) pajisjet me fuqi nominale më pak se 6 kW që përdorin qarkullimin e lirë dhe janë projektuar vetëm për prodhimin e ujit të nxehtë që ruhet për nevoja higjeno-sanitare;
- dh) bojlerët e prodhuar jashtë serie;
- e) “pajisjet ko-gjeneruese” të cilat prodhojnë në të njëjtën kohë energji elektrike dhe ujë të nxehtë.

3.2. Në rastin e bojlerëve me funksionim të dyfishtë, si për ngrohjen e ndërtesave ashtu dhe për të siguruar ujë të nxehtë për nevoja higjeno-sanitare, kërkesat e efikasitetit të referuara në nënpikën 5.1 i përkasin vetëm funksionit të ngrohjes.

4. Mbikëqyrja e tregut

4.1 Nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet vendosja në treg ose në shërbim e pajisjeve dhe bojlerëve të cilat plotësojnë kushtet e këtij Rregulli Teknik dhe që kanë markimin CE, të parashikuar në pikën 8, duke dëshmuar përputhjen me të gjithë kushtet e këtij Rregulli Teknik, duke përfshirë procedurat e vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në pikën 9.

4.2 Nuk lejohet vendosja në treg/në përdorim e bojlerëve të cilat nuk përmbushin kërkesat e efikasitetit të dhëna në nënpikën 5.1, si dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi në lidhje me kushtet klimaterike lokale, energjinë dhe karakteristikat e ndërtesave. Struktura përgjegjëse e Mbikëqyrjes së Tregut në Ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe përgjegjëse për bojlerët e parashikuar për përdorim nga konsumatorët dhe Inspektorati përgjegjës në Ministrinë e industrisë për bojlerët e parashikuar për përdorim jo-konsumator (më poshtë SPMT përkatëse) marrin të gjithë masat e

nevojshme për të siguruar se bojlerët nuk mund të vendosen në shërbim nëse ato nuk plotësojnë kërkesat e efikasitetit.

4.3 Megjithatë, SPMT përkatëse, në të gjitha ato raste kur back-boilerat dhe/ose bojlerët që mund të instalohen në hapësira banimi janë plotësisht të instaluar përpara miratimit të këtij Rregulli Teknik, do të vijojnë të autorizojnë vijueshmërinë e tyre në shërbim, me kusht që rendimenti i tyre si për fuqinë nominale ashtu dhe në 30% të ngarkesës nuk është më shumë se 4% poshtë kërkesave të përcaktuara për bojlerët standard në pikën 5.1

4.4. Efektet e dispozitave në nënpikat 4.2 dhe 4.3 do të monitorohen në mënyrë periodike nga ministritë përkatëse sipas fushës së tyre përkatëse të përgjegjësisë.

4.5 a) Kur bojlerët janë objekt edhe i Rregullave të tjerë Teknik që mbulojnë aspekte të tjera të cilët gjithashtu parashikojnë vendosjen e markimit CE, ky i fundit do të tregojë se këta bojlerë janë gjithashtu të prezumuar në përputhje me kushtet e këtyre Rregullave Teknike.

b) Kur një ose më shumë nga këto Rregulla Teknikë i lejojnë prodhuesin, që gjatë një periudhe kalimtare, të zgjedhë cilin rregull të zbatojë, vendosja e markimit CE do të tregojë përputhjen vetëm me dispozitat e Rregullave Teknike të zbatuara nga prodhuesi.

Në këtë rast, veçoritë e Rregullave Teknike të zbatuara, të publikuara në Fletoren Zyrtare, duhet të jepen në dokumentat, shënimet ose instruksionet e kërkuara nga Rregullat Teknikë dhe që shoqërojnë bojlerët.

5. Konformiteti me kërkesat thelbësore të efikasitetit (rendiment i dobishëm)

5.1 Boilerët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme të efikasitetit (rendimentit të dobishëm):

a) në fuqinë nominale, duke operuar në fuqinë nominale P_n të shprehur në kW, në një temperaturë mesatare 70°C të ujit të boilerit, dhe

b) në ngarkesë të pjesshme, duke operuar në 30% të ngarkesës, në një temperaturë mesatare të ujit të boilerit e cila ndryshon sipas tipit të boilerit.

Kërkesat thelbësore të efikasitetit (rendimentit të dobishëm) që duhet të plotësohen janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tipi i boilerit	Kufiri i fuqisë	Efikasiteti në fuqi nominale		Efikasiteti në ngarkesë të pjesshme	
		Temperatura mesatare e ujit në boiler (në °C)	Kërkesa e efikasitetit të shprehur në (%)	Temperatura mesatare e ujit në boiler (në °C)	Kërkesa e efikasitetit të shprehur në (%)
Boilerët standarde	4 deri 400	70	$\geq 84 + 2 \log P_n$	≥ 50	$\geq 80 + 3 \log P_n$



Bojlerë me temperaturë të ulët (*)	4 deri 400	70	$\geq 87.5 + 1.5 \log P_n$	40	$\geq 87.5 + 1.5 \log P_n$
Bojler me kondesim me gaz	4 deri 400	70	$\geq 91 + 1 \log P_n$	30 (**)	$\geq 97 + 1 \log P_n$

Tabela

(*) Duke përfshirë bojlerët me kondesim që përdorin lëndë djegëse të lëngët.

(**) Temperatura e ujit me të cilin furnizohet bojleri.

5.2 Standardet e harmonizuar lidhur me kërkesat e këtij Rregulli Teknik përcaktojnë, ndër të tjera, edhe metodat e verifikimit të vlefshme për prodhimin dhe matjet.

Tolerancat e përshtatshme duhet të përfshihen në nivelet e rendimentit.

6. Vendosja e Markimit CE të konformitetit

6.1 Boilerët të cilët janë në përputhje me standardet e harmonizuara, presumohet se plotësojnë kërkesat thelbësore të eficientës të përcaktuara në nënpikën 5.1. Tek këta bojlerë duhet të vendoset markimi CE referuar në nënpikën 8.1 dhe të shoqërohen nga deklarata EC e konformitetit.

6.2 Përputhshmëria e serive të prodhuara të bojlerëve vërtetohet nga:

a) shqyrtimi i eficientës së një tipi bojleri në përputhje me modulën B, siç përshkruhet në nënpikën 9.1;

b) një deklaratë konformiteti e tipit të miratuar në përputhje me modulën C, D ose E të përshkruara në nënpikat 9.2, 9.3 dhe 9.4.

Për bojlerët që djegin lëndë djegëse të gaztë, procedurat për vlerësimin e konformitetit të eficientës së tyre do të jenë ato që përdoren për të vlerësuar përputhjen me kërkesat e sigurisë të përcaktuara në Rregullin Teknik përkatës mbi pajisjet që përdorin lëndë djegëse të gaztë.

6.3 Kur pajisjet e tregtuara vendosen në treg të ndara, ato duhet të kenë markimin CE dhe të shoqërohen nga deklarata EC e konformitetit, e cila përcakton parametrat që mundësojnë që pas montimit të arrijnë nivelet e rendimentit të dobishëm të përcaktuara në nënpikën 5.1.

6.4 Vendosja e markimit CE të konformitetit me kërkesat e këtij Rregulli Teknik dhe me ato të kushteve të tjera në lidhje me dhënien e së drejtës së përdorimit të markimit CE, si dhe mbishkrimet e specifikuar në pikën 8, do të vendosen mbi bojlerët në mënyrë të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe të paheqëshme. Ndalohej vendosja mbi këto produkte e çdo shenje tjetër që mund të çorientojë palët e treta si në kuptimin ashtu dhe në formën e vendosjes së

markimit CE. Çdo shenjë tjetër mund të vendoset tek bojlerët dhe pajisjet vetëm me kusht që të mos ulët dukshmëria dhe lexueshmëria e markimit CE.


6.5 a) Kur SPMT përkatëse ose organizmi evropian i notifikuar/dega e tij e regjistruar dhe miratuar në Shqipëri nga Ministri përgjegjës për industrinë (këtu e më poshtë OEN/OM) konstaton se markimi CE është vendosur në mënyrë jo të rregullt, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të bëjë pajtueshmërinë e bojlerit me kushtet e lidhura me vendosjen e markimit CE dhe t'i japë fund shkeljes sipas kushteve të vëna nga Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

b) Kur mospërputhja vazhdon, merren të gjitha masat administrative për kufizimin ose ndalimin e bërjes së disponueshme në treg të produktit në fjalë ose siguron tërheqjen e tij nga tregu dhe informon menjëherë ministrin përkatës.

7. Ministria përgjegjëse për industrinë publikon në faqen zyrtare të internetit listën e organeve të miratuara, OEN/OM dhe numrat e tyre të identifikimit dhe fushat për të cilat ato janë miratuar.

8. MARKIMI CE DHE MARKIME TE TJERA SPECIFIKE

Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet “CE” sipas formës së mëposhtme:



a) Nëse markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet, respektohen përmasat e vizatimit të mësipërm të shkallëzuar.

b) Komponentët e markimit CE duhet të kenë të njëjtën përmasë vertikale e cila nuk duhet të jetë më pak se 5 mm.

9. Modulet e vlerësimit të konformitetit

9.1 Shqyrtimi EC i tipit (Moduli B)

9.1.1 Shqyrtimi EC i tipit është procedura nëpërmjet së cilës një OEN/OM vërteton dhe deklaron se mostra përfaqësuese e prodhimit të parashikuar plotëson kushtet përkatëse të Rregullit Teknik.

9.1.2 Aplikimi për shqyrtimin EC të tipit paraqitet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar tek një OEN/OM i zgjedhur nga vetë ai:

Aplikimi duhet të përfshijë:



- a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse aplikimi bëhet nga përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe emrin dhe adresën e tij;
- b) një deklaratë me shkrim se i njëjti aplikim nuk është paraqitur në një tjetër OEN/OM;
- c) dokumentacioni teknik, siç përshkruhen në nënpikën 9.1.3.

Aplikanti vë në dispozicion të OEN/OM një mostër përfaqësuese të prodhimit të parashikuar, me poshtë e quajtur “tipi”. OEN/OM kërkon mostra të tjera nëse është e nevojshme për të kryer programin e provës.

9.1.3 Dokumentacioni teknike duhet të mundësojnë përputhjen e pajisjes me kërkesat e vlerësuara nga ky Rregull Teknik.

Ato, për një vlerësim të tillë, duhet të mbulojnë projektimin, prodhimin, dhe funksionimin e pajisjes dhe përmbajnë:

- a) një përshkrim të përgjithshëm të tipit;
- b) projektin konceptual, vizatime prodhimi dhe skema të komponentëve, nën-nyjave, qarqeve, etj;
- c) përshkrimet dhe sqarimet e nevojshme për kuptimin e vizatimeve dhe skemave si dhe për funksionimin e produktit;
- ç) një listë të standardeve të harmonizuara, të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, të përcaktuara në nënpikën 5.2, dhe përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të plotësuar kërkesat thelbësore të Rregullit Teknik kur standardet e harmonizuar të përcaktuar në pikën 5 nuk janë zbatuar;
- d) rezultatet e përllogaritjeve të bëra gjatë projektimit, shqyrtimet e bëra, etj;
- dh) raportet e provave të kryera;

9.1.4 OEN/OM duhet:

- a) të shqyrtojë dokumentacionin teknik, verifikon nëse tipi është prodhuar në përputhje me këto dokumentacion dhe identifikon elementet të cilët janë projektuar në përputhje me kushtet përkatëse të standardeve të harmonizuara të përcaktuara në nënpikën 5.2 si dhe elementët të cilët janë projektuar pa zbatuar dispozitat përkatëse të këtyre standardeve;
- b) të kryejë vetë ose nëpërmjet të tjerëve shqyrtimet përkatëse dhe provat e nevojshme për të verifikuar nëse zgjidhjet e përshtatura nga prodhuesi plotësojnë kërkesat thelbësore të Rregullit Teknik, atje ku nuk janë zbatuar standardet e harmonizuara të përcaktuara në nënpikën 5.2;
- c) të kryejë vetë ose nëpërmjet të tjerëve shqyrtimet përkatëse dhe provat e nevojshme për të verifikuar nëse prodhuesi që ka zgjedhur të zbatojë standardet përkatëse, aktualisht i ka zbatuar ato.
- ç) të bjerë dakord me aplikantin për vendet ku do të kryhen shqyrtimet dhe provat e nevojshme.

9.1.5 Kur tipi plotëson dispozitat përkatëse të këtij Rregulli Teknik, OEN/OM i lëshon aplikantit një certifikatë të shqyrtimit EC të tipit. Certifikata përmban emrin dhe adresën e prodhuesit, konkluzionin e shqyrtimit dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të aprovuar.

Një listë të pjesëve përkatëse të dokumentacionit teknik i aneksohet certifikatës dhe një kopje mbahet nga OEN/OM.



Nëse prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar i refuzohet çertifikata e tipit, OEN/OM jep arsyet e detajuara për këtë refuzim.

Në këtë rast parashikohet procedurë apelimi.

9.1.6 Aplikanti informon OEN/OM, i cili mban dokumentet teknike në lidhje me çertifikatën e shqyrtimit EC të tipit për të gjitha modifikimet në pajisjen e aprovuar, për të cilat duhet të marrë aprovim tjetër, kur ndryshime të tilla mund të ndikojnë në përputhshmërinë me kërkesat thelbësore ose me kushtet e përshkruara për përdorimin e produktit. Aprovimi tjetër jepet në formën e një shtese tek çertifikata origjinale e shqyrtimit EC të tipit.

9.1.7 OEN/OM u komunikon OEN/OM të tjerë informacionin përkatës lidhur me çertifikatat e shqyrtimit EC të tipit dhe shtesat e miratuara ose heqjen e tyre.

9.1.8 OEN/OM, mund të marrin kopje të çertifikatave të shqyrtimit EC të tipit dhe/ose shtesat e tyre. Aneksat e çertifikatave të shqyrtimit EC të tipit mbahen në dispozicion të OEN/OM.

9.1.9 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban së bashku me dokumentacioni teknik edhe kopjet e çertifikatave të shqyrtimit EC të tipit dhe shtesat e tyre për një periudhë së paku 10 vjet që nga prodhimi i fundit i produktit përkatës.

Kur as prodhuesi as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk janë në Shqipëri, detyrimi për mbajtjen në dispozicion të dokumentacionit teknik është nën përgjegjësinë e personit që vendos produktin në treg.

9.2 Konformiteti i tipit (Moduli C)

9.2.1 Ky modul përshkruan atë pjesë të procedurës me anë të së cilës prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar siguron dhe deklaron se pajisjet në fjalë janë në përputhje me tipin, e përshkruar në çertifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe plotëson kërkesat e këtij Rregulli Teknik që zbatohen mbi to. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të vendosë markimin CE në çdo pajisje dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

9.2.2 Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se procesi i prodhimit garanton përputhjen e pajisjeve të prodhuara me tipin, siç përshkruhet në çertifikatën e shqyrtimit EC të tipit, si dhe me kërkesat e efikasitetit të këtij Rregulli Teknik.

9.2.3 Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban një kopje të deklaratës së konformitetit të paktën për një periudhë 10 vjecare nga data e fundit e prodhimit të produktit në fjalë.

Kur as prodhuesi as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk ndodhen në Shqipëri, detyrimin për disponibilitetin e dokumenteve teknike e ka personi që vendos produktin në treg.

9.2.4 OEN/OM i zgjedhur nga prodhuesi kryen ose detyron kryerjen e shqyrtimeve të produktit në intervale rastësore. Një mostër e përshtatshme e produktit që merret në vendin e prodhimit nga OEN/OM shqyrtohet dhe testohet, sipas standardit/eve përkatës të përcaktuar në nënpikën 5.2 ose kryhen prova të njëvlershme për të kontrolluar përputhjen e produktit me kërkesat përkatëse të Rregullit Teknik.

Në rastin kur një ose më shumë mostra të produkteve të shqyrtuara nuk janë në përputhje, OEN/OM duhet të marrë masat përkatëse.



9.3 Sigurimi i cilësisë së prodhimit (Moduli D)

9.3.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës prodhuesi i cili plotëson detyrimet e nënplikës 9.3.2 siguron dhe deklaron se pajisjet janë në përputhje me tipin e përshkruar në çertifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe plotëson kërkesat e Rregullit Teknik që zbatohet mbi to. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin CE në çdo pajisje dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

Markimi CE shoqërohet nga numri i identifikimit i OEN/OM përgjegjës për kontrollet e përcaktuara në nënplikën 9.3.4.

9.3.2 Prodhuesi duhet të operojë me një sistem të aprovuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin përfundimtar të pajisjes dhe provave, të përcaktuara në nënplikën 9.3.3. dhe është objekt i kontrolleve të përcaktuara në nënplikën 9.3.4.

9.3.3 Sistemi i cilësisë

9.3.3.1 Prodhuesi paraqet aplikimin për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për pajisjet tek OEN/OM i zgjedhur nga vetë ai:

Aplikimi përfshin:

a) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e parashikuar të pajisjes,

b) dokumentet lidhur me sistemin e cilësisë

c) dokumentet teknike mbi tipin e aprovuar dhe një kopje të çertifikatës të shqyrtimit EC të tipit.

9.3.3.2 Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e pajisjeve me tipin e përshkruar në çertifikatën e shqyrtimit EC të tipit dhe me kërkesat e Rregullit Teknik që zbatohen mbi to.

Të gjithë elementet, kërkesat dhe kushtet e përshtatura nga prodhuesi dokumentohen me shkrim në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve. Dokumentet e sistemit të cilësisë lejojnë një interpretim të qëndrueshëm të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe regjistrave/dosjeve teknike të cilësisë.

Ai duhet të përmbajë veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm të:

a) objektivave të cilësisë, strukturës organizative, përgjegjësi dhe kompetencave të menaxhimit në lidhje me cilësinë e pajisjes;

b) prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikave të sigurimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që janë përdorur;

c) shqyrtimeve dhe provave që kryen përpara, gjatë dhe pas prodhimit, dhe frekuencën me të cilën ato kryhen;

ç) regjistrave të cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, të dhëna mbi kalibrimin si dhe raporte mbi kualifikimin e personelit të përfshirë në to, etj

d) mënyrave të monitorimit të realizimit të cilësisë së kërkuar të pajisjes dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

9.3.3.3 OEN/OM vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e përcaktuara në nënplikën 9.3.3.2. Ai prezumon përputhjen me ato kërkesa që lidhen me sistemet e cilësisë që zbaton standardi përkatës i harmonizuar. Ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një



anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së produktit përkatës. Proçedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në ambientet punës së prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.3.3.4 Prodhuesi merr përsipër plotësimin e detyrimeve të dala nga sistemi i aprovuar cilësisë dhe e ruan atë në një nivel të përshtatshëm dhe efektiv.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban të informuar, për çdo ndryshim të parashikuar në sistemin e cilësisë OEN/OM që ka aprovuar sistemin e cilësisë.

OEN/OM vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë plotëson kërkesat e përcaktuara në nënpikën 9.3.3.2 apo kërkohet një rivlerësim i tij.

Ai njofton prodhuesin mbi vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.3.4 Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e OEN/OM

9.3.4.1 Mbikëqyrja ka si qëllim që të sigurojë se prodhuesi përmbush siç duhet detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

9.3.4.2 Prodhuesi duhet të lejojë OEN/OM të hyjë për qëllime inspektimi në ambientet e prodhimit, inspektimit, provave dhe magazinimit dhe t'i sigurojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht mbi:

- a) dokumentet e sistemit të cilësisë;
- b) regjistrat e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, të dhëna mbi kalibrimin, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj

9.3.4.3 OEN/OM periodikisht kryen auditime që sigurojnë se prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe e pajis prodhuesin me një raport auditimi.

9.3.4.4 OEN/OM mund të bëjë vizita të palajmëruara tek prodhuesi.

Gjatë vizitave të tilla, OEN/OM mund të kryejë prova ose detyron të kryhen prova për të verifikuar që sistemi i cilësisë funksionon korrektësisht; nëse duhet OEN/OM pajis prodhuesin me një raport mbi vizitën dhe, nëse ka kryer prova dhe raportin e provave.

9.3.5 Prodhuesi, për një periudhë të paktën 10 vjet nga prodhimi i fundit i produktit, mban në dispozicion të SPMT përkatëse:

- a) dokumentin e përcaktuar në nënpikën 9.3.3.1.b);
- b) të dhënat e përcaktuara në nënpikën 9.3.3.4 b
- c) vendimet dhe raportet e OEN/OM që janë të përcaktuara në nënpikën 9.3.3.4 paragrafi i fundit dhe nënën pikat 9.3.4.3 dhe 9.3.4.4;

9.3.6 Çdo OEN/OM informon organizmat e tjerë evropian të notifikuar/organe të miratuara mbi informacionin përkatës lidhur me lëshimin e aprovimeve të sistemit të cilësisë ose heqjen e tyre.

9.4 Sigurimi i cilësisë së produktit (Moduli E)



9.4.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës prodhuesi i cili plotëson detyrimet e nënplikës 9.4.2 siguron dhe deklaron se bojlerët dhe pajisjet janë në përputhje me tipin e përshkruar në çertifikatën e shqyrtimit EC të tipit. Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin CE në çdo bojler dhe pajisje dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

Markimi CE shoqërohet nga numri i identifikimit i OEN/OM përgjegjës për kontrollet siç përcaktohet në nënplikën 9.4.4.

9.4.2 Prodhuesi operon me një sistem të aprovuar cilësie për inspektimin përfundimtar dhe testimin e bojlerit dhe pajisjes siç specifikohet në pikën 9.4.3. dhe është objekt i kontrolleve siç përcaktohet në pikën 9.4.4.

9.4.3 Sistemi i cilësisë

9.4.3.1 Prodhuesi paraqet tek një OEN/OM, të zgjedhur nga vetë ai, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për bojlerët dhe pajisjet e tij.

Aplikimi përfshin:

- a) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e kërkuar të boilerit ose pajisjes;
- b) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- c) dokumentet teknike lidhur me tipin e aprovuar dhe një kopje të çertifikatës së shqyrtimit CE të tipit.

9.4.3.2 Mbështetur në sistemin e cilësisë, çdo bojler ose pajisje i nënshtrohet shqyrtimit dhe kryerjes së provave përkatëse siç përcaktohet në standardin/et përkatës përcaktuar në nënplikën 5.2 ose kryerjes së testeve të barasvlershme që të sigurohet përputhja e tij me kërkesat përkatëse të Rregullit Teknik.

Të gjithë elementet, kërkesat dhe kushtet e përshtatura nga prodhuesi dokumentohen me shkrim në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë lejon një interpretim në mënyrë të rregullt të programeve të cilësisë, planeve, manualeve dhe dosjeve teknike

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm të:

- a) objektivave të cilësisë, strukturës organizative, përgjegjësisë dhe kompetencave të menaxhimit në lidhje me cilësinë e pajisjes;
- b) shqyrtimeve dhe provave të kryera pas prodhimit;
- c) mënyrave të monitorimit për funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë;
- ç) regjistrave të cilësisë/dosjeve teknike të cilësisë, të tilla si raporte inspektimi, të dhëna mbi testimet, të dhëna mbi kalibrimet, raporte të kualifikimit të personelit të të përfshirë në to, etj;

9.4.3.3 OEN/OM vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e përcaktuara në nënplikën 9.4.3.2. Ai prezumon përputhjen me ato kërkesa që lidhen me sistemet e cilësisë që zbaton standardi përkatës i harmonizuar.



Ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së produktit përkatës. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në ambientet punës së prodhuesit.

Vendimi i njoftohet prodhuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.4.3.4 Prodhuesi merr përsipër plotësimin e detyrimeve të dala nga sistemi i aprovuar cilësisë dhe e mirëmban atë në një nivel të përshtatshëm dhe efektiv.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban të informuar, për çdo ndryshim të parashikuar në sistemin e cilësisë OEN/OM që ka aprovuar sistemin e cilësisë.

OEN/OM vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë plotëson kërkesat e përcaktuara në 9.4.3.2 apo kërkohet një rivlerësim i tij.

Ai njofton prodhuesin mbi vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

9.4.4 Mbikëqyrja/Monitorimi nën përgjegjësinë e OEN/OM 9.4.4.1 Mbikëqyrja ka si qëllim që të sigurojë se prodhuesi përmbush siç duhet detyrimet që rrjedhin nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

9.4.4.2 Prodhuesi duhet të lejojë që OEN/OM të hyjë për qëllime inspektimi në ambientet e prodhimit, inspektimit, provave dhe magazinimit dhe t'i sigurojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht mbi:

- a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë,
- b) dokumentet teknike,
- c) regjistrat e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, të dhëna mbi kalibrimin, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj;

9.4.4.3 OEN/OM periodikisht kryen auditime që sigurojnë se prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe e pajis prodhuesin me një raport auditimi.

9.4.4.4 OEN/OM bën vizita të pa lajmëruara tek prodhuesi.

Gjatë vizitave të tilla, OEN/OM kryen prova ose detyron të kryhen prova për të verifikuar që sistemi i cilësisë funksionon korrektësisht; nëse duhet, OEN/OM e pajis prodhuesin me një raport mbi vizitën dhe, nëse ka kryer prova, edhe me raportin e provave.

9.4.5 Prodhuesi, për një periudhë të paktën 10 vjet nga prodhimi i fundit i boilerit ose i pajisjes, mban në dispozicion të SPMT përkatëse:

- a) dokumentet e referuara në nënpikën 9.4.3.1 c),
- b) ndryshimet e referuara në nënpikën 9.4.3.4 paragrafi i dytë,
- c) vendimet dhe raportet e OEN/OM të cilat janë përcaktuar në nënpikën 9.4.3.4 paragrafi i fundit, në nënpikën 9.4.4.3 dhe 9.4.4.4.

9.4.6 Çdo OEN/OM informon OEN/OM e tjera mbi informacionin përkatës lidhur me lëshimin e aprovimeve të sistemit të cilësisë ose heqjen e tyre.

10. Procedurat e vlerësimit të konformitetit të bojlerëve në përdorim



10.1 Personi përgjegjës, referuar përcaktimit në Ligjin 10489/2011, i ndryshuar, ka përgjegjësinë t'ia nënshtrojë bojlerët vlerësimeve vjetore periodike të konformitetit, në përputhje me instruksionet e dhëna nga prodhuesi, dhe standardet e harmonizuara siç referohet në pikën 2 të këtij vendimi.

10.2 Bojlerët e vënë në shërbim/përdorim përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të cilat nuk mbartin markimin CE të konformitetit, dhe nuk janë të pajisur me Deklaratën CE të Konformitetit prej prodhuesit, do të prezumohen se janë në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik, pas pajisjes me certifikatën e konformitetit të lëshuar nga një OEN ose organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit, referuar përcaktimeve të ligjit 10489/2011, i ndryshuar.

10.3 SPMT mbikëqyr zbatimin e kësaj kërkesë..

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE QË KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË BOJLEREVE

NR	Titulli i standardit në shqip	Viti i adoptimit si SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
1.	<u>S SH EN 14394:2005+A1:2008</u> Kaldaja për ngrohje - Kaldajat me djegës me shfryrës ajri - Fuqia termike nominale më e vogël ose e barabartë me 10 MW dhe temperaturë maksimale të punës prej 110°C	2009	Fp
2.	<u>S SH EN 15035:2006</u> Kaldaja për ngrohje – Kërkesa të veçanta për kaldajat me injektorë me lëndë djegëse të lëngët me dhomën e ruajtjes me fuqi jo më të madhe se 70 kW	2006	Fp
3.	<u>S SH EN 13836:2006</u> Gjenerator ajri të ngrohtë që ushqehen me gaz, për përdorim në sera dhe në ngrohjen shitesë në ambientet jo shtëpiake	2007	Fp
4.	<u>S SH EN 15502-2-1:2012</u> Kaldaja për ngrohje qëndrore me djegie gazi – Standardi specifik për pajisjet e tipit C dhe pajisjeve të tipeve B2, B3 dhe B5 me një futje nominale të nxehtësisë jo më të madhe se 1 000 kW	2013	Fp
5.	<u>S SH EN 15502-2-2:2014</u> Kaldaja për ngrohje qëndrore me djegie gazi – Pjesa 2-2: Standardi specifik për zbatimin e tipit B1	2015	Fp
6.	<u>S SH EN 303-7:2006</u> ngrohje - Pjesa 7: Kaldaja për ngrohje qëndrore me djegie gazi të pajisura me djegës me fryrje me dhënie nxehtësie që nuk i kalon 1000 kW	2007	Fp